

VENDIM
Nr. 307, datë 22.5.2024

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE FITUESE TË FINANCUARA PËR VITIN
2024 NGA FONDI PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE
NATYRORE, SI DHE TË AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR ZBATIMIN E
PROJEKTEVE, SIPAS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 15, e të pikës 9, të aneksit 6, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

NR	BASHKIA	OBJEKTI (EMËRTIMI I PROJEKTIT)	VLERËSIMI PARAPRAK	AUTORITET KONTRAKTOR	VLERA E PLOTË E PROJEKTIT (NË LEKË)	FINANCIMI PËR VITIN 2024 (NË LEKË)	FINANCIMI PËR VITIN 2025 (NË LEKË)	PROJEKT NË VAZHDIM VITI 2024	PROJEKT I RI VITI 2024
1	Pustec	Sistemimi i shtratit të përroit në Goricë e Madhe për mbrojtjen e fshatit nga përmbytja (projekt 2023).		Bashkia	37,121,808	3,401,738.00		3,401,738.0	
2	Krujë	Punime për rehabilitimin e shkarkuesit, rezervuari Vrijon (projekt 2023).		Bashkia	13,282,080	13,282,080.00		13,282,080.0	
3	Kolonjë	Rezervuar i Gjonçit, prita malore në fshatrat Mësiçkë, Taç poshtë (projekt 2023).		Bashkia	23,097,273	929,985.00		929,985.0	
4	Tropojë	Ndërtim ura të reja, rikonstruksion ura e vepra ujitëse (projekt 2023)		Bashkia	19,183,239	3,965,765.88		3,965,765.9	
5	Durrës	Përforcim terreni nga rrëshqitja në zonën e NJ.A nr. 2, nr. 4, Ishëm (projekt 2023)		Bashkia	5,541,743	5,541,742.90		5,541,742.9	
6	Malësi e Madhe	Ura lidhëse për fshatrat Vermosh–Velan–Velipojë (projekt 2023).		Bashkia	64,302,850	29,944,810.00		29,944,810.0	
7	Kuçovë	Mbrojtje nga gërryerja e rrugës kryesore në përroin e Lumasit, krahu i majtë pranë Urës së Lumasit, ndërtimi i tri urave në përroin e Saraselasit, Belesovës dhe Mendrakës, si dhe ndërtimi i rrugës lidhëse (projekt 2023).		Bashkia	39,732,870	27,821,190.00		27,821,190.0	
8	Dropull	Mbrojtja nga përroi i Selosë, Dropull, faza I (projekt 2023).		Bashkia	29,708,823	2,477,829.00		2,477,829.0	
9	Klos	Ndërtim urë betoni-armë 4*17 m mbi lumin Mat, në fshatin Dom, Nj. A Gurrë, Klos (projekt 2023).		Bashkia	84,604,287	74,554,947.00		74,554,947.0	
10	Gjirokastrë	Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Çfakës, pranë rrugës nacionale Gjirokastrë–Kakavijë, loti 2 (projekt 2023).		Bashkia	34,541,506	34,541,506.00		34,541,506.0	
11	Pogradec	Sistemim i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij, loti I (projekt 2023).		Bashkia	84,129,945	37,979,952.60		37,979,952.6	
12	Has	Rehabilitim i kënetës dhe bazamentit të kanalit të betonit, përroi i Tërshanës (projekt 2023).		Bashkia	6,693,060	112,200.00		112,200.0	
13	Kurbin	Sistemi i përroit të qytetit të Laçit.	100.0	Bashkia	99,999,051	34,999,667.85	64,999,383.2	-	34,999,667.9
14	Përrenjas	Rikonstruksion i kanalit të Xhelos, faza e dytë dhe sistemim i ujërave të larta në Krastën e Përrenjasit, Qyteti Përrenjas.	99.0	Bashkia	21,009,043	21,009,042.90	-		21,009,042.9
15	Selenicë	Rehabilitim dhe mbrojtje nga përroi Hotimë.	98.0	Bashkia	61,362,240	21,476,784.00	39,885,456.0		21,476,784.0
16	Gramsh	Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore.	98.0	Bashkia	98,442,888	34,455,010.80	63,987,877.2		34,455,010.8
17	Cërrik	Mbrojtja nga gërryerja dhe përmbytja e fshatit Selit, faza I.	98.0	Bashkia	44,242,228	15,484,779.80	28,757,448.2		15,484,779.8
18	Korçë	Ndërtimi i pritave malore dhe mbrojtjeve lumore në njësitë administrative, Bashkia Korçë.	98.0	Bashkia	14,306,726	14,306,726.21	-		14,306,726.2
19	Mat	Rikonstruksion ure pasarele në fshatin Rreth–Bazë, NJ. A Bazë, Bashkia Mat (projekt 2023).		Bashkia	17,897,979	11,396,247.94		11,396,247.9	
		Mbrojtja nga përroi i Urakës, Nj. A Rukaj, Bashkia Mat.	97.0	Bashkia	60,077,218	21,027,026.22	39,050,191.6		21,027,026.2
20	Devoll	Mbrojtje nga ujërat e larta dhe sistemimi i përroit të SMT-së (projekt 2023).		Bashkia	42,828,640	42,828,639.60		42,828,639.6	
		Sistemim përroi, fshati Dobranj.	97.0	Bashkia	13,561,295	13,561,295.21	-		13,561,295.2
21	Peqin	Ndërrhyrje emergjente në argjinaturën e lumit Shkumbin për shmangien e shembjes së rrugës Cengalaj–Shezë, Bashkia Peqin.	97.0	Bashkia	59,629,619	20,870,366.65	38,759,252.4		20,870,366.7
22	Librazhd	Mbrojtje lumore në lumin e Gostimës L=171 m vendi midis rrugës dhe hidrocentralit, si dhe segmenti i përroit Sheh nga ura e përroit deri tek vendtakimi në lumin e Gostimës 70 m+10 m.	96.0	Bashkia	17,086,265	17,086,265.01	-		17,086,265.0
23	Memaliaj	Riparimi i shkarjeve në rrugët e njësjve administrative	96.0	Bashkia	85,009,319	29,753,261.65	55,256,057.4		29,753,261.7

		Luftinjë dhe Buz.							
24	Bulqizë	Rehabilitim dhe sistemim i Përroit të Thatë, Nj. A Fushë-Bulqizë, Bashkia Bulqizë.	96.0	Bashkia	29,866,215	14,933,107.50	14,933,107.5		14,933,107.5
25	Korçë	Sistemimi i Përrrenjve brenda territorit të Bashkisë Korçë.	95.0	Bashkia	74,107,506	25,937,627.03	48,169,878.8		25,937,627.0
26	Roskovec	Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeçarit (viti 2023).		Bashkia	53,274,162	10,284,154.00		10,284,154.0	
		Mbrojtje nga lumi Seman në krahun e majtë, zona Suk, Bashkia Roskovec.	95.0	Bashkia	51,314,021	17,959,907.35	33,354,113.7	-	17,959,907.4
27	Fier	Rehabilitimi i argjinaturës së lumit Vjosa, zona Ferras.	95.0	Bashkia	35,986,095	17,993,047.50	17,993,047.5		17,993,047.5
28	Maliq	Zhblllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës (projekt 2023).		Bashkia	51,439,062	24,902,166.00		24,902,166.0	
		Rehabilitim rita malore në infrastrukturën e dëmtuar Zëmlak e Plasë.	95.0	Bashkia	81,169,812	28,409,434.20	52,760,377.8		28,409,434.2
		Ndërtimi i stacionit të pompimit + linja, Bashkia Maliq (Viti 2022)		Bashkia	45,250,027	4,519,329.00		4,519,329.0	
29	Vau i Dejës	Ndërtim ure në lumin Drin, Pistull–Stajkë.	95.0	Bashkia	15,614,627	15,614,626.62	-		15,614,626.6
30	Delvinë	Riparim ura e Vanës.	95.0	Bashkia	26,772,986	13,386,493.00	13,386,493.0		13,386,493.0
31	Skrapar	Mbrojtje ure mbi lumin e Tomorricës, krahun e majtë dhe i djathtë në hyrje dhe dalje.	95.0	Bashkia	62,955,078	22,034,277.44	40,920,801.0		22,034,277.4
32	Poličan	Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodicë, Poličan.	95.0	Bashkia	98,275,135	51,340,791.14	46,934,343.9		51,340,791.1
33	Shkodër	Reduktimi i pasojave të përmbytjes e zonën e nënshkodrës (Projekt 2023).		Bashkia	13,733,376	13,733,376.00		13,733,376.0	
		Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës.	94.0	Bashkia	12,162,007	12,162,007.00	-		12,162,007.0
34	Patos	Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforcim bazamenti dhe rikonstrukcion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave.	94.0	Bashkia	39,730,565	19,865,282.40	19,865,282.4		19,865,282.4
35	Konispol	Mbrojtje lumore në tokat e Markatit.	92.0	Bashkia	32,598,448	11,409,456.80	21,188,991.2		11,409,456.8
36	Dimal	Mbrojtje lumore në fshatin Arrëz, Bashkia Dimal (projekt 2023).		Bashkia	37,402,182	25,824,582.00		25,824,582.0	
		Mbrojtje lumore në zonën e Dafinave, Bashkia Dimal.	92.0	Bashkia	27,572,125	13,786,062.50	13,786,062.5		13,786,062.5
37	Elbasan	Mbrojtja e lagjes Neneve nga gërryerja e përroit të Gostimës, fshati Polis Valë, Nj. A Shushicë.	92.0	Bashkia	27,082,570	13,541,285.00	13,541,285.0		13,541,285.0
38	Lezhë	Rindërtimit të urës në fshatin Kodër Mulliri, Lezhë.	91.0	Bashkia	17,417,955	17,417,955.00	-		17,417,955.0
39	Finiq	Ndërtim muri mbajtës në shkarjen e fshatit Krane.	90.0	Bashkia	10,038,674	10,038,674.00	-		10,038,674.0
40	Berat	Ndërhyrje rehabilituese në muret mbajtës dhe terrenet në territorin e bashkisë, në kuadër të mbrojtjes civile.	90.0	Bashkia	13,584,586	13,584,585.80	-		13,584,585.8
41	Kukës	Rehabilitim i urave në fshatrat gështenjë, Orgjost (projekt 2023)		Bashkia	10,180,188	514,800.00		514,800.0	
		Riparim i urave në segmentin rrugor Turaj, Rruga Nacionale Shishtavec.	90.0	Bashkia	1,903,765	1,903,765.28	-		1,903,765.3
42	Tiranë	Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerozës tek Fresku L=620 m (projekt 2023).		Bashkia	50,196,953	31,784,969.00		31,784,969.0	
		Ndërhyrje emergjente në rrugën Rexhekri, fshati Surrel, Nj. A Dajt.	90.0	Bashkia	98,026,795	34,309,378.22	63,717,416.7		34,309,378.2
TOTALI					2,095,046,909	1,000,000,000	731,246,867	400,342,010	599,657,990